



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 26/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Muhamet Rexha dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 11.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

II. Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 4800 (katërmijetëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.01.2011, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet se në Gazetën ditore “Express” të datës 08.01.2011, në faqen nr. 14 – Marketing - është ekspozuar fotografia e kandidatit për deputet të PDK-së, ashtu që nuk është respektuar heshtja zgjedhore nga ana e kandidatit Behar Selimi nga radhët e subjektit politik PDK. Me këtë parashtruesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e nenit 36 par. 1 pika (b) i LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 1 (një) kopje të faqes nr. 14 të gazetës ditore “Express” të datës 08.01.2011, në të cilën është ekspozuar fotografia e Behar Selimit kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik PDK më përmbajtje të fushatës parazgjedhore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK, më datë 10.01.2011, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 11.01.2011, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit

Dispozita ligjore e Nenit 36 paragrafi 1 pika (b) i LZP-së, dhe neni 6 paragrafi 1 pika (d) e *Rregullës Zgjedhore nr.11/2009* parashohin se:

36.1 Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohej secili prej veprimeve të më poshtme:

b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Neni 6 par. 1 pika (d) e Rregullës Zgjedhore nr.11/2009:

d) të shfrytëzojnë mediat lokale ose ndërkombëtare më qellim të ndikimit në votues

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se subjekti politik PDK ka ekspozuar fotografën e kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Behar Selimi, në Gazetën ditore "Express" në faqen nr.14 më datë 08.01.2011, më përmbajtje të fushatës parazgjedhore. Data 08.01.2011, ka qenë ditë e heshtjes zgjedhore për rivotimin e zgjedhjeve të 09.01.2011, për këtë arsye PZAP konstaton se ekspozimi i fotografive me përmbajtje të fushatës parazgjedhore në ditën e heshtjes zgjedhore është në kundërshtim më dispozitat e lartcekura ligjore. Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 26/2011 më datën 11.01.2011

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

